



Byroja e zhvillimit të arsimit

# Doracak për shoqëri për klasën IV

---

Rizvan Bela

Liljana Samarxhiska - Panova

Danica Talimxhioska

Subi Ajro

Jasminka Nestorovska – Ivanoska

dr. Igor Jurukov

Vanço Petrushevski

Shtator, 2017

## HYRJE

Lënda mësimore *shoqëri* është lëndë e detyrueshme në arsimin fillor nëntëvjeçar në Republikën e Maqedonisë. Kjo lëndë realizohet prej klasës së I (parë) deri në klasën e V (pestë) dhe zë vend të rëndësishëm në mësim. Në pajtim me planin mësimor, lënda shoqëria në klasën e IV (katërt) realizohet me 2 orë në javë përkatësisht 72 orë në vit.

Programi mësimor në shoqëri përmban tre tema dhe për realizimin cilësor dhe efikas të qëllimeve në këto tema me rëndësi të veçantë është planifikimi i mësimdhënësit. Megjithatë ai duhet të nisët nga karakteristikat zhvillimore të nxënësve, nga njohuritë e përvetësuarat paraprake nga lënda e njëjtë mësimore nga klasa e parë deri në klasën e tretë, me vëmendje të bëjë zgjidhje të mjeteve mësimore dhe materialeve dhe e përmbajtjeve (në pajtim me qëllimet mësimore) ndërsa gjithashtu me vëmendje t'i zgjedh metodat e punës, format adekuate organizuese të punës, t'i kuptimësojë aktivitetet të cilët janë interesante dhe stimuluese për nxënësit dhe të cilët shpeshherë duhet të dalin nga situatat jetësore (sepse njohuritë që i arrijnë nxënësit duhet të jenë praktike dhe të ndryshme).

Veçanërisht duhet theksuar domosdoshmëria e mësimdhënësit që t'i dalloj mirë nxënësit e paraleles së tij që të mundet t'i planifikojnë në mënyrë reale orët mësimore. Për shkak të ndjeshmërisë së temës „Familje, amvisëri dhe shoqëri“ ai duhet me vëmendje t'i zgjedh aktivitetet për nxënësit ndërsa ka nxënës të cilët nga arsye personale nuk dëshirojnë të jenë pjesë e aktiviteteve, mësuimdhësnësi për ata duhet të planifikojë dhe të propozojë aktivitete tjera.

Do të ishte mirë që mësimi në lëndën e shoqërisë të planifikohet dhe të realizohet në mënyrë të integruar, duke e pasur parasysh atë që kjo lëndë jep mundësi të madhe për ndër lidhjen e përmbajtjeve me lëndët tjera si: gjuhë amtare, arsim figurativ, arsim muzikor, arsim fizik dhe shëndetësor dhe lëndën zgjedhore dhe krijimtarinë. Sa i përket aktiviteteve dhe metodave mësimore duhet të dominojnë vëzhgimet, veprimet hulumtuese dhe metodat tjera për mësimin interaktiv. Vëzhgimi duhet të kuptohet si pjesë përbërëse e procesit mësimor dhe si rezultat i punës edukative – arsimore, meqë aftësia për

vëzhgim zhvillohet përmes rrugës së mësimit. Aktivitetet hulumtuese janë kryesisht situata mësimore të organizuara, në të cilët nxënësi mëson përmes rrugës së zgjidhjes së problemit. Aplikimi gradual i nxënësve në zgjidhjen e situatave problematike (hulumtimi) është i domosdoshëm në mësimin e *shoqërisë*. Mësimdhënësi i organizon aktivitetet dhe i nxit nxënësit për parashtrimin e pyetjeve ndërsa në atë mënyrë ata bëhen të shkathtë në parashtrimin e pyetjeve në të cilat vetë do të përgjigjen me përpjekje dhe hulumtim. Zhvillimi i proceseve logjike dhe zgjidhja e problemeve janë qëllime të rëndësishme e kësaj lënde mësimore. Kur nxënësit parashtrojnë pyetje, kur zbulojnë dhe japin përgjigje mësimdhënësi duhet t'ju ndihmojë që t'i rrisin shkathtësitë e veta për të menduarit. Madje ju parashtron pyetje të hapura si për shembull: Çka mundesh të më tregosh për këtë? Vallë pse kjo ndodh? Sqaro se çka ke bërë. Në çka të rikujton kjo? Çka do të mund të ndodh nëse ...? etj. Ai duhet të parashtojë pyetje të hapura, të llojit: Vallë? Si? Çka nëse? Duhet të shmangen pyetje të mbyllura dhe nxënësve duhet t'ju jepet kohë e mjaftueshme për të menduar para se të përgjigjen në pyetjet. Me rëndësi është që në aktivitetet e ndryshme të nxënësve të bisedojnë me situata të ndryshme problematike dhe të hasin zgjidhje të ndryshme për ata.

Gjithashtu lojërat dhe aktivitetet e lojës duhet shpesh herë të organizohen. Në lojëra fëmija në mënyrë specifike e përjeton dhe dallon botën që e rrethon i paraqet ndjenjat dhe impresionet e tij ndaj botës, e pasuron jetën e tij emotive, mëson se si të veprojë në mjedis, e formon personalitetin e tij dhe në mënyrë më natyrore i kënaq nevojat e veta për lëvizje dhe aktivitet. Për njohjen e nxënësve me mjedisin shoqëror është i domosdoshëm zbatimi i lojërave didaktike dhe në përgjithësi lojërave me rregulla. Karakteristike për lojërat krijuese është ajo që vetë nxënësit janë krijues të përmbajtjes së tyre, në qëllimin e parashtruar dhe në mënyrën e realizimit të tyre. Në lojërat krijuese të fëmijëve më tepër dominojnë tema nga jeta e të rriturve, ndërsa nxitje për lojën më tepër paraqet vëzhgimi paraprak i kryer, i aktivitetit të caktuar i të rriturve, të ndonjë ngjarje apo dukurie. Në lojërat didaktike fëmijët janë të vendosur para detyrës së caktuar që duhet ta zgjedhin, duke u bazuar në rregullat e caktuara. Gjatë realizimit të lojës fëmijët shfrytëzojnë materiale didaktike të llojllojshme me çka prej tyre kërkohet ta rradhisin, të manipulojnë me atë. Duke u përkujdesur për kureshtjen spontane të fëmijës mësimdhënësi

duhet ta vështrojë nxënësin, t'i zbulojë dëshirat e tij, afinitetet dhe aftësitë si dhe të krijojë kushte për zhvillimin dhe përparimin e tij të mëtejshëm.

Përveç metodës së lojës, metodës së vështrimit dhe metodës së hulumtimit, mësimdhënësi shpesh herë duhet t'i zbatojë edhe: metodën e të folurit (monolog, dialog dhe metodën e diskutimit), metodën tekstuale (tekstet, fletat e punës dhe detyrën individuale), metodën e demonstrimit (varg ilustrimesh, fotografi, aplikacione), metoda ilustrative (ilustrime objektsh, simbole etj), metodën e punës praktike etj. Në shembujt e orëve të planifikuara të dhëna në doracak në veçanti janë shkruar metodat mësimore. Mësimdhënësit kanë lirinë gjatë planifikimit të orëve që t'i veçojnë metodat mësimore si pjesë e planifikimit, ndërsa mundet njëkohësisht në përshkrimin e orës (aktivitetet hyrëse, mësimdhënies –mësimnxënies dhe aktivitetet përfundimtare) t'i zbatojnë apo theksojnë në atë tekst.

Mësimdhënësi duhet ta nxitë punën e pavarur dhe në grupe të nxënësve, ta përkrah kreativitetin dhe inventivitetin e tyre përmes teknikave të ndryshme të prezantimit: stuhi ideshë, simulimi i situatave, luajtja në role, stop, t – tabela, kubi, ditari, pesërreshtëshi, Diagrami i Venit, organizimi i punëtorive gjatë zgjidhjes së problemeve me karakter praktik. Mënyra e punës duhet të mundësojë komunikim ndërmjet nxënësve, bashkëpunim, hulumtim të përbashkët, plotësim etj. Që të krijohen kushte për pjesëmarrje të barabartë në aktivitetet dhe sjelljen e konkluzave dhe vendimeve.

Nxënësit më mirë mund ta njohin mjedisin e drejtëpërdrejtë shoqëror. Përmbajtjet që realizohen duhet të jenë sa e më aktuale. Mësimdhënësi duhet t'i shfrytëzojë ngjarjet aktuale dhe situatat në paralelet dhe t'i përfshijë në punën e nxënësve. Kështu që nxënësit më lehtë do të mundet ta ndërlidhin përvojën e arritur jashtë shkollës me atë në mësim. Mësimin do ta kenë më afër nxënësve nëse mësimdhënësi i ndërlidh përmbajtjet me kuptim ndërsa gjatë ndërlidhjes duhet të jetë e qartë se cilët janë qëllimet edukative – arsimore.

Në përpilimin e orës së mësimdhënësit rëndësi të veçantë ka plani për notim me çka ai duhet të planifikojë se me cilët aftësi bëhet vlerësimi dhe cilët veprime dhe instrumente do t'i shfrytëzojë. Vlerësimi në rradhë të parë shfrytëzohet për stimulimin e zhvillimit të nxënësit. Me vlerësimin dijagnostik

shqyrtohet gjendja fillestare që është bazë e parashikimit të mundësive të nxënësit dhe për planifikimin e punës. Vlerësimi formativ realizohet në vazhdimësi gjatë tërë vitit shkollor paralelisht me realizimin e procesit mësimor. Qëllimi kryesor është që të angazhohen nxënësit në vetëvlerësim dhe vetëbesim. Gjatë vlerësimit dhe notimit formativ mësimdhënësi duhet të mbaj llogari për punët vijuese, çka dëshiron të dijë, pse kjo është e rëndësishme etj); përcaktimi i mënyrave të përcjelljes se si nxënësi mendon, si i zgjidh problemet, cilët lloj të gabimeve i bën; reaksione informata reciproke të mësimdhënësit që do ta udhëzojnë mësimin e nxënësit (kërkimi i sqarimit se si ka arritur në diçka, vallë pse kështu mendon, udhëzime që mund të provojë më ndryshe, vetëvlerësim që mendon se ka bërë mirë e çka jo, vendosja e qëllimeve afatshkurte dhe afatgjate bashkë me nxënësit) dhe informimi i prindit për njohuritë nga vlerësimi formativ dhe dhënia e udhëzimeve se si të punojnë ata. Në përcjelljen, vlerësimin dhe notimin formativ me rëndësi është cilësia e informatave formative që ua jep mësimdhënësi nxënësve dhe prindërve. Informata cilësore reciproke i përmbush nevojat zhvillimore të nxënësit, meqë e orienton dhe i ndihmon që ta arrijë këtë nivel për të cilin posedon potenciale. Madje mësimdhënësi duhet të zbatojë një numër të madh metodash, veprimesh, teknikash dhe instrumente. Për përcjelljen dhe vlerësimin e nxënësve shfrytëzohen: vëzhgimi, biseda, të gjithë llojet me gojë, praktike dhe vlerësimi me shkrim. Për grumbullimin dhe shënimin e të dhënave dhe informatave në sjelljen, përgjigjet dhe përpunimeve të nxënësve shfrytëzohen: pyetësor, fleta për vlerësim, çek lista, shkallë gjykimesh etj. Shumë i rëndësishëm është edhe vlerësimi i mendimeve të nxënësve dhe për këtë nevojitet që të planifikohen detyra.

Do të jetë mirë që pas përfundimit të temës apo nëntemës nxënësit të bëjnë tekst të përbashkët të paraleles nga aktivitetet e realizuara dhe materialet e grumbulluara nga vëzhgimet, nga fletat e punës në orët (shembull., libër për komunën, libër për vendbanimin, libër për jetën familjare etj). Mund të përpilohen edhe libra nga disa grupe nxënësish.

Në librin e mëtejshëm ka shembuj të parashtruar të aktiviteteve që mësimdhënësi mund t'i shfrytëzojë, tërësisht apo me ndryshime, në pajtim me specifikat e paraleles.

### III. SHEMBUJ TË AKTIVITETEVE SIPAS TEMAVE MËSIMORE

#### TEMA 1:FAMILJA, AMVISËRIA DHE SHOQËRIA

##### Shembulli 1

**Njësia mësimore:**Jeta familjare

**Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja t'i zgjerojë njohuritë për familjen si bashkësi gjinore.

**Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja e din që familja është bashkësi e prindërve dhe fëmijëve;
- e din se çka nevojitet për funksionimin e mirë të një familje.

**Mjetet mësimore dhe materialet:**mjetet për të shkruar dhe për vizatim, fletë mësimore.

**Metodat mësimore:**metoda e të folurit, metoda e vështrimit dhe metoda e demonstrimit, metoda e tekstit.

**Vendi i realizimit:**klasa

**Vijimi i orës**

#### AKTIVITETET HYRËSE

Mësimdhënësi i rikujton nxënësit me teknikën pesërreshtësh (në rradhën e parë qëndron fjala familje, rradha e dytë është me dy mbiemra të ndërlidhur me fjalën familje, rradha e tretë është me tre folje, njëkohësisht të ndërlidhura me fjalën familje, rradha e katërt përbëhet nga katër fjalë që formojnë fjali për familjen – të përdorura më lartë paraprakisht, reshti i fundit është fjalë sinonim dhe fjala familje).

Nxënësit thirren me tërheqjen e shkopthave prej druri nga gota në të cilët janë të shkruara emrat e tyre. Nxënësi i tërhequr tregon fjalë adekuate apo fjali dhe atë e shkruan në tabelë. Nëse nuk din tërhiqet nxënësi tjetër. Mësimdhënësi e lexon të shkruarën për familjen.

### **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Me aktivitetin hyrës mësimdhënësi/mësimdhënësja e paraqet qëllimin në orë dhe shkruan në tabelën: jeta familjare.

Madje sqaron se çka është familja dhe bashkarishtë me nxënësit njerr përfundim se familja është bashkësi e prindërve dhe fëmijëve.

Çka është e nevojshme që të funksionojë mirë një familje?

Me nxënësit bisedohet për familjen dhe me sjelljen e anëtarëve të familjes. Mësimdhënësi parashtron pyetje:

Çka është dashuria prindore?

Çka nënkupton që të ketë respekt familjar?

Çka do të ndodh në një familje kur fëmijët nuk pajtohen?

Çka do të ndodh nëse prindërit nuk i respektojnë mendimet e fëmijëve?

Nxënësit japin supozime të veta dhe i argumentojnë.

Çka do të ndodh nëse fëmijët nuk e respektojnë mendimin e prindërve?

Nxënësit japin supozimet e tyre dhe i argumentojnë.

Mësimdhënësi vazhdon të bisedojë me nxënësit për ndërlidhjen e anëtarëve të një familje, mënyrat se si ata tregojnë dashuri për prindërit e tyre ashtu që bashkë vjen deri te përfundimi se për funksionimin e mirë të familjes nevojitet: respekt, dashuri dhe mirëkuptim.

Nxiret përfundim se forma më karakteristike e fisit për një numër më të madh familjesh është farefsnia e gjakut apo natyrore që krijohet me lindjen e fëmijëve.

## AKTIVITETET EVALUATIVE

Mësimdhënësi ju ndan nxënësve fleta punepër vlerësimin e njohurive dhe ju jep instruksione për punë.

E përcjell punën e pastaj ndërsa i grumbullon fletat mësimore.

### Kriteret e vlerësimit:

- nxënësi/nxënësja e din që familja është bashkësi e prindërve dhe fëmijëve;
- e din se për funksionimin e mirë të një familje nevojitet: dashuri, respekt dhe mirëkuptim

**Detyrë shtëpie:** Secili nxënës të shkruan pesë fjali për familjen e vetë.

### Fleta pune

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_

### Jeta familjare

1. Kush e përbën familjen?

---

---

2. Sqaro pse është e nevojshme të ekzistojë respekt, dashuri dhe mirëkuptim në familje.

---

---

---

3. Shëno një shembull sa i përket asaj se me çka pajtohesh me prindërit Tuaj.

---



---

4. Shëno një shembull me çka nuk pajtohesh me ndonjë anëtar të familjes tënde.

---

---

---

## **Shembulli 2**

**Njësia mësimore:**Llojet e familjeve

### **Qëllimet:**

- nxënësi/nxënësja t'i sqarojë njohuritë për familjen;
- të mësojë se anëtarët e secilës familje i ndërlidhin punët e njejta.

### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja e din që familja është bashkësi e prindërve dhe fëmijëve;
- e din se çka nevojitet për funksionimin e mirë të një familje.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e vështrimit, metoda e demonstrimit dhe metoda e tekstit.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** pjesë letre (stikerë), lapsa, fotografi ku janë paraqitur: familje e të dy prindërve me një fëmijë se si ecin, familje me të dy tutor me tre fëmijë në shëtitje në natyrë; baba me dy fëmijë në shitore; nëna dhe një fëmijë sesi ngasin biçikletë.

**Vendi i realizimit:** klasa

**Vijimi i orës**

## **AKTIVITETE HYRËSE**

Të gjithë nxënësit marrin për detyrë në një copë letre t'i shkruajnë emrat e anëtarëve të familjes. Nxënësit ndahen në çifte dhe secili/secila nxënës

shokut në çift t'ia tregojë emrat e secilit anëtar të familjes dhe diçka të bukur për secilin prej tyre.

## **AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES - MËSIMNXËNIES**

Mësimdhënësi i paralajmëron të gjithë nxënësit se do t'ju shpjegojë tregime të shkurtëra për disa familje. Ua tregon fotografitë e ndryshme (një nga një) në të cilët janë paraqitur lloje të ndryshme të familjeve dhe për secilën familje të paraqitur tregon emra të ndryshëm të anëtarëve të familjes, madje ku jetojnë (shtëpia, banesa), ndërsa shpjegimi për të gjithë familjet tregon se anëtarët e famijeve duhen ndërmjet veti, kujdesen për tjerët (finansiarisht, kur janë të sëmurë, kur kanë ndonjë problem etj)respektohen ndërmjet veti (bisedojnë, respektojnë këshilla, urojnë ditëlindje etj), tregojnë mirëkuptim (kur janë të lodhur, kanë obligime të ndryshme, nevojë për ndihmë gjatë mësimit, interesim për sport etj) përkrahen ndërmjet veti (për interesa, dëshira nevoja për rregullimin e këndit të vetë, dhomë në shtëpi etj), shkojnë bashkërisht në shëtitje, ekskurzione, shoqërohen me farefisë dhe miq, bëjnë sport etj.

Mësimdhënësi len kohë për pyetje me çka përgjigjet në pyetjet e parashtruara. Madje i ndan nxënësit në grupe. Në secilin grup secili nxënës të tjerëve të grupit duhet t'ju tregojë nga ndonjë shembull për aktivitetet e përbashkëta me prindërit, me vëllezërit dhe motrat (nëse ka), se si kujdesen prindërit dhe japin përkrahje ndërsa jetojnë me gjyshen dhe gjyshin se si prindërit e tyre tregojnë kujdes për prindërit e vetë.

Mësimdhënësi bisedon me nxënësit për atë se çka është ndryshe e çka është ngjashëm me familjet për të cilat u ka treguar si dhe për të personat e afërt për të cilët kanë dëgjuar nga shokët e tyre. Mandej bashkërisht nxjerrin përfundim se ka lloje të ndryshme të familjeve, kujdesen njëri ndaj tjetrit, kuptohen dhe përkrahen.

## **AKTIVITETET EVALUATIVE:**

Mësimdhënësi ju ndan nxënësve fletë për vlerësimin e njohurive. E përcjell punën e tyre ndërsa i grumbullon fletat që t'i analizojë përgjigjet.

## **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja i din karakteristikat themelore të llojeve të ndryshme të familjeve: familje më e gjërë, familje me ni prind dhe familje prej jetimore;
- e di se anëtarët e secilës familje duhet t'i bashkojë dashuria, respekti, kujdesi, mirëkuptimi, përkrahja.

### **Fletë pune**

**Emri dhe mbiemri:** \_\_\_\_\_

Rretho përgjigjen e saktë.

1. Familjet nga prindërit dhe fëmijët e tyre quhen:

- a) bashkësi martesore.
- b) familje më e ngushtë.
- c) familje më e gjerë.

2. Familja me një prind është familje në të cilën jetojnë:

- a) gjyshi, gjyshja dhe nipi.
- b) prindër dhe një fëmijë.
- c) një prind dhe fëmijë.

Familje më e zgjeruar është:

- a) familje me një prind dhe disa fëmijë.
- b) familje me dy prindër dhe disa fëmijë.
- c) familje në të cilën bashkë jetojnë disa gjenerata (prindër, fëmijë, gjysh dhe gjyshe).

Familje jetimore është:

- a) kur fëmija/fëmijët jetojnë me njerëz të cilët nuk i kanë prindër ndërsa ata e marrin tërë kujdesin përsipër për ata.
- b) kur fëmijët jetojnë me prindërit e tyre në shtëpi.
- c) kur në familje jetojnë edhe farefis tjetër.

Njerëzit të cilët nuk janë prind të fëmijës kurse tërësisht kujdesen për atë janë:

- a) tutor të tij.
- b) fqinjë të tij.

Sipas teje çka është e përbashkët për të gjithë llojet e familjeve?

---

---

---

---

### **Shembulli 3**

**Njësia mësimore:**Familja në histori dhe sot

#### **Qëllimet:**

- nxënësi/nxënësja t'i sqarojë njohuritë për familjen në të kaluarën dhe sot;

#### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja e din që roli i anëtarëve të familjes ka kaluar përmes historisë;
- e din se çka nevojitet për funksionimin e mirë të një familje.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e vështrimit, metoda e demonstrimit dhe metoda e tekstit.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** LCD – projektor, kompjuter, fotografi të familjes në të kaluarën dhe sot, fragment nga drama „ Padroni Teodos”.

**Vendi i realizimit:** klasa

#### **Vijimi i orës**

#### **AKTIVITETE HYRËSE**

Mësimdhënësi në fillim i pyet të gjithë nxënësit: Çka është familja?

Cilët janë anëtarët e familjes?

Çfarë lloj familjesh ekzistojnë?

## AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES

Me nxënësit vazhdojnë biseda për atë se vallë kanë dëgjuar apo kanë parë në TV emisione për atë se si kanë jetuar familjet në të kaluarën (sa anëtarë kanë pasur, cili ka qenë „koka e familjes”, si ka qenë raporti i ndërsjellë, çka kanë punuar).

Nxënësit përcjellin insert nga drama „Padroni Teodos” nga Vasil Iloski.

Mandej zhvillohet bisedë për situatat e paraqitura në familje në dramën, raportet e ndërsjella të njerëzve/personazhëve dhe karakteristikat e familjeve përmes historive. (shembull., roli i babait/nënës në familje, përkatësisht ndaj vajzës/djalit, djalit/vajzës – lidhje martesore etj.

Mësimdhënësi parashton pyetje: Çka ju kanë shpjeguar gjyshet apo gjyshërinjtë tuaj për fëmijërinë e tyre?

Çka ju shpjegojnë për prindërit tuaj për fëmijërinë e tyre? Madje paraqiten fotografi/ilustrime të familjes në të cilën prindërit dhe fëmijët merren vesh, bashkërisht e rregullojnë shtëpinë, bashkërisht planifikojnë për familjen. Mësimdhënësi pyet: Çka vëreni në fotografitë/ilustrimet? Çka ndodh? Vallë pse mendoni kështu?

Nxënësit ndahen në grupe, bisedojnë ndërsa mandej nga secili grup kërkohet të numërojnë shembuj të cilët e karakterizojnë familjen bashkëkohore.

## AKTIVITETET EVALUATIVE

Secili nxënës pranon detyrë individuale që t’i shkruajë në kolona karakteristikat e bashkësisë moderne dhe të familjes nga e kaluara.

**Emri dhe mbiemri:** \_\_\_\_\_

Familja në të kaluarën	Familje bashkëkohore

--	--

**Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja i din disa karakteristika të familjes bashkëkohore dhe të familjes nga e kaluara;
- thekson shembuj të familjeve ku rol dominues ka babai, nëna;
- mund të theksoj dhe të sqarojë shembuj të disa karakteristikave të familjes bashkëkohore.

**Shembulli 4**

**Njësia mësimore:** Familja dhe raportet në familje

**Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja ta njeh lidhshmërinë e anëtarëve të familjes dhe rolin e prindërve/tutorëve në edukimin e fëmijëve.

**Rezultatet e pritura:**

- Nxënësi/nxënësja e din se ekziston lidhja e anëtarëve në familje;
- e din se prindërit/tutorët kujdesen për edukimin e fëmijëve të tyre.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e vështrimit dhe metoda e demonstrimit,

**Mjetet mësimore dhe materialet:** letër, laps.

**Vendi i realizimit:** klasa

**Vijimi i orës**

**AKTIVITETET HYRËSE**

Mësimdhënësi fillon bisedë me nxënësit në lidhje me rolin e prindit/tutorit në jetën bashkëkohore. Pas mbarimit të bisedës bashkarisht nxjerrin përfundim se prindërit/tutorët kujdesen për mjetet financiare për sigurimin e shtëpisë, ushqimit, veshjes, kujdesit shëndetësor, arsimimit të fëmijëve të tyre etj. Madje merret parasysh edhe ndjeshmëria e temës dhe biseda përshtatet në atmosferën në paralele.

Në këtë mënyrë sqarohet rëndësia e rolit të prindit/tutorit në zhvillimin e fëmijës.

Mësimdhënësi vazhdon me bisedën duke vënë theks të veçantë në rolin e prindit/tutorit në edukimin e fëmijëve të tyre. Ai i nxit nxënësit të mendojnë për situatat kur ndihma dhe përkrahja e prindërve/tutorëve shumë ka qenë e nevojshme si dhe udhëzimet për sjelljen e duhur ndaj tyre, përkatësisht ndaj obligimeve etj.

Biseda me nxënësit udhëhiqet në drejtim të arsytimit të veprimeve të prindërve ndaj fëmijëve dhe e kundërta si dhe nevoja e fëmijëve për prindërit.

## **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup zgjedh një nga temat e ofruara për luajtjen në role.

- Zgjedhja e hobi – „hobi i imponuar“;
- Mësimi dhe të shkruarit e detyrave të shtëpisë;
- Kërkimi i fëmijës për të blerë telefon, kompjuter etj.

*Mësimdhënësi dhe nxënësit kanë liri të propozojnë tema tjera nëse mendojnë se do të jenë më adekuate dhe më të pranueshme për ata.*

Në kuadër të secilit grup nxënësit ndahen në çifte ashtu që secili çift duhet të luaj role dhe t'i vështrojë çiftet tjera në grup. (Secili çift vetë vendos se cilin rol do ta luaj – roli i prindit apo i fëmijës sipas dëshirës mund t'i ndryshojnë rolet.)

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Pas mbarimit të aktivitetetve paraprake të theksuara, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të japin parashikimet e tyre se vallë veprimi i prindërve dhe i fëmijës në situatë konkrete ishte adekuate, i mirë dhe jo i mirë.

Parashtrihen pyetje të llojit:

- Cila sjellje (apo veprim) sipas jush ishte në rregull?
  - Pse mendoni se „prindi/tutori“vepron kështu?
  - Pse mendoni se „fëmija“vepron kështu?
  - Vallë e arsyetoni veprimin e tij dhe pse?
  - Si do të mundet të veprohet më ndryshe?
- Mësimdhënësi mund të parashtrijë edhe pyetje tjera të këtij lloji.

Ai i pyet nxënësit se si janë ndje në rolin e prindit dhe në rolin e fëmijës se cili rol ka qenë më i vështirë.

Nxënësit bashkërisht me mësimdhënësin nxjerrin konkluzë se: prindërit kujdesen për fëmijët e tyre, duhet t'ju besojnë atyre, t'i përkrahin, t'ju japin këshilla për sjelljen e tyre ndërsa në anën tjetër fëmijët duhet t'i respektojnë këshillat dhe rekomandimet e prindërve/tutorëve. Njiherit, fëmijët duhet duhet t'ua shprehin prindërve mendimet, propozimet dhe vërejtjet e tyre sepse kështu mendojnë se prindërit duhet t'i respektojnë dhe marrin parasysh të drejtat e fëmijëve për të shprehurit e mendimit personal.

#### **Kriteret e vlerësimit**

- nxënësi/nxënësja e kuptojnë rolin e prindit/tutorit në jetën familjare;
- numëron disa obligime të tyre në shtëpi;
- kupton se këshillat e prindërve në edukim janë qëllim mira dhe në interes të fëmijëve;
- e din se ka të drejtë ta shpreh mendim e tij.

#### **Shembulli i 5**

**Njësia mësimore:** Unë vendosi për fshehtësitë e tyre

#### **Qëllimet:**

- nxënësi/nxënësja të kuptojë se çka është privatësia;
- ta njeh dallimin ndërmjet informatave që i përkasin privatësisë edhe atë të cilët janë publike.

#### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja të kuptojë se çka është privatësia;
- ta njeh dallimin ndërmjet informatave që i përkasin privatësisë edhe atë të cilët janë publike.

**Metodat mësimore:**metoda e të folurit,metoda e hulumtimit.

**Mjetet mësimore dhe materialet:**fleta pune, t – tabelë dhe fletë pune me detyra, laps.

**Vendi i realizimit:**klasa.

**Vijimi i aktivitetit**

#### **AKTIVITETET HYRËSE**

Fillohet bisedë e shkrutër me nxënësit për atë se vallë kanë fshehtësi



prej kujt i fshehin dhe pse.

Madje vetë ndahen spontanisht në çifte, ndërsa secili çift merr detyrë që të jep ndonjë informatë e cila do të jetë fshehtësi e tyre (ndonjë ndodhi, ngjarje, kur kanë qenë të hidhëruar, të turpëruar, simpatia, shqetësimi).

Pas shkëmbimit të informatave kërkohet se vallë ndonjë prej nxënësve vullnetarisht kërkon që informatën e vetë ta ndajë me tjerët. Kur do të ndahet me të gjithë nxënësit ajo informatë bëhet publike.

Kështu që nxënësit njihen se në vazhdim të orës do të punojnë për atë që paraqet fshehtësi, privatësi dhe çka është ajo që mundet të ndahet.

### **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Nxënësit ndahen në grupe varësisht nga numri i paraleles dhe marrin detyrë që të mendojnë dhe të shkruajnë shembuj të informatave të cilët i konsiderojnë si të fshehta (nuk ndahen me dikend) dhe shembuj të informatave që mundet të ndahen me tjerët - publike.

Si informata të njejta të shkruajnë komente përkatësisht arsyetim me të cilin guxojnë apo nuk guzojnë t'i ndajnë.

Përgjigjet i shkruajnë në t - tabelë.

<b>Anformatat të fshehta</b>	<b>Arsyetimi</b>

<b>Informatat publike</b>	<b>Arsyetimi</b>

--	--

Në vijim përfaqësuesit e grupit i prezantojnë përgjigjet dhe së bashku me nxënësit tjerë komentojnë.

Mësimdhënësi i nxit nxënësit që në mënyrë të pavarur të nxjerrin konkluzat.

### **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Nxënësve ju jepet fletë pune me detyrë që secili ta shkruaj numrin para fjalës, pohimit, fjalisë në fushën adekuate në Diagramin e Venit.

Megjithatë përgjigjet e shkruara diskutohen publikisht dhe secili nxënës vetëvlerësohet në raport me përgjigjet.


### **Fletë pune**

**Emri dhe mbiemri:** \_\_\_\_\_

Detyrë:

Shëno numrin e shkruar para fjalës, nocionit, fjalisë në fushën adekuate në Diagramin e Venit me shkronjat A, B, C.

- A –informata të fshehta
- B – informatat të cilët mund të bëjnë pjesë në A dhe C;
- C– informata publike.



- 1.Vetëm unë kam të drejt ta lexoj ditarin tim.
- 2.Trokit para se të hysh.
- 3 .Nora garonte në këndim në konkursin në TV.
- 4.Manifestimi i ditëlindjes.
- 5.Sara e lut mësimdhënësen e saj që notën e testit mos ta tregojë para tjerëve.
- 6.Zorani ruan kafshë përkdhelëse – lepur.
- 7.Klara shkruan poezi dhe këngë i grumbullon në fletore të posaçme.
- 8.Simpatia.

### Kriteret e vlerësimit:

- nxënësi/ nxënësja sqaron se çka është privatësia;
- e din se disa informata nuk shpërndahen me dikend;

### Shembulli 6

**Njësia mësimore:** Aktiviteti im në shtëpi

#### Qëllimet:

- nxënësi/nxënësja t'i kuptojë rolin, rëndësinë dhe funksionet, e amvisërisë dhe aktivitetet që kryhen në të.

#### Rezultatet e pritura:

- nxënësi/nxënësja din se të gjithë anëtarët e familjes duhet kujdesur për shtëpinë;

– i di obligimet në shtëpi.

**Metodat mësimore:**metoda e të folurit, metoda e demonstrimit, teksti.

**Materialet dhe mjetet mësimore:**fletat e punës, letër flipçart,

**Vendi i realizimit:**klasa.

**Vijimi i aktivitetit**

### **AKTIVITETET HYRËSE**

Mësimdhënësi e fillon orën me bisedë të shkrutër për rolin e aktivitetit të secilit anëtar në shtëpi.Parashtron pyetje të llojit:

Çfarë është roli dhe cilët janë aktivitetet e nënës në shtëpi?

Çka bën nëna shpeshherë në shtëpi?

Çfarë është roli dhe cilët janë aktivitetet e babait në shtëpi?

Çka bën babai shpeshherë në shtëpi?

Si është roli dhe cilët janë aktivitetet e gjyshes, gjyshit në shtëpi (nëse jetojnë në bashkësi)?

Çka bëjnë më tepër ata?

Si është roli dhe cilët janë aktivitetet e vëllait/motrës në shtëpi ?

Cili është roli yt dhe cilët janë aktivitetet tuaja në shtëpi?

### **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Nxënësit deklarohen në lidhje me pyetjet e parashtruara.

Mësimdhënësi ndërlidhet me pjesën hyrëse dhe diskutimin e vazhdon në drejtim që nxënësit të mendojnë për rolin e tij dhe për aktivitetet në shtëpi ndërsa njëkohësisht edhe për përgjegjësitë e veta.

Secili nxënës/nxënëse pranon fletë pune që duhet ta plotësojë.

**Fleta e punës: Aktivitetet në shtëpi**

**Emri dhe mbiemri:**\_\_\_\_\_

Detyrë: Lexoj aktivitetet e shtëpisë dhe ndërlidhe secilin aktivitet me anëtarin e familjes për të cilët mendon se duhet ta bëjnë.

Aktivitetet e nënës	Kujdeset për higjienën në shtëpi. Furnizon ushqim.
Aktivitetet e babait	Përgatit. Lan enë.
Aktivitetet e gjyshes	Hedh mbeturina. I ujit lulet.
Aktivitetet e gjyshit	Kujdeset kafshët përgëdhelëse. Rregullon punë në shtëpi.
Aktivitetet e vëllait/motrës	Ndërron poçet elektrike. I rradhit lodrat.
Aktivitetet e mia	Kujdeset për tekstet shkollore/fletoret.

Mësimdhënësi i lut disa nxënës që të lexojnë vullnetarisht se si ata i kanë ndërlidhur aktivitetet me anëtarët e shtëpisë dhe të sqarojnë se pse kanë vepruar ashtu.

Në bisedë inkuadrohen edhe nxënësit tjerë të cilët japin shembuj të tyre dhe argumente.

Mësimdhënësi duhet të komentojë nëse paraqiten gjykime të nxënësve të cilët shpiejnë në stereotipe gjinore.

### **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Në fund të aktivitetit mësimdhënësi ngjet letër flipçart ku janë të vendosura elementet e njejta nga fleta e theksuar paraprakisht.

Nga konkluzat e nxjerrura konstatohet se disa aktivitete mund t'i realizoj nëna, babai, fëmijët dhe anëtarët tjerë të familjes ndërsa disa kanë të bëjnë me anëtarë të caktuar të familjes.

Në fund bashkërisht e plotësojnë listën e paraqitur në letër flipçart.

#### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja e din se të gjithë anëtarët e familjes duhet të kujdesen për shtëpinë;
- i numëron dhe i sqaron obligimet e veta në shtëpi;
- i vëren dhe përpiqet t'i tejkaloj stereotipet gjinore në raport me obligimet e shtëpisë.

## **Shembulli i 7**

### **Njësia mësimore: Pronësia**

#### **Qëllimet:**

- nxënësi/nxënësja të mësojë se çka është pronësia;
- t'i mësojë dallimet themelore ndërmjet pronësisë personale dhe të përbashkët.

#### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja të mësojë se çka është pronësia;
- t'i kuptojë dallimet themelore ndërmjet pronësisë personale dhe të përbashkët.

**Metodat mësimore:**metoda e të folurit, metoda e demonstrimit, teksti.

**Materialet dhe mjetet mësimore:** fletë letre formati A4, gërshërë, kartela me aplikacione të gjësendeve nga pronësia personale dhe e përbashkët dhe në hamer.

**Vendi i realizimit:** klasa.

### **Vijimi i aktivitetit**

#### **AKTIVITETE HYRËSE**

Mësimdhënësi në fillim të orës kërkon nga nxënësit që të numërojnë gjësende që janë në kompetenca të tyre. Pastaj bashkërisht nxjerrin definicion për nocionin pronësi që në vete përfshin sqarim për atë se çka e përbën pronësinë personale. Mësimdhënësi parashtron pyetje për shembull. Çka do të ndodh nëse persona tjerë shfrytëzojnë gjëra tuaja personale? Kjo është me qëllim që nxënësit të mendojnë dhe t'i shikojnë pasojat negative të shfrytëzimit të gjësendeve të huaja personale (psh. brushë për dhëmbë, krehër, fletore...).

#### **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Mësimdhënësi i njofton nxënësit se përveç gjësendeve personale (që u përkasin vetëm atyre) ekzistojnë edhe gjëra që janë të përbashkëta (në grupe) dhe u përkasin disa njerëzve (për shembull, brusha e dhëmbëve është pronësi personale, ndërsa pasta e dhëmbëve më tepër është në pronësi të përbashkët të anëtarëve të familjes etj). Nxënësit japin shembuj të tyre, numërojnë gjësende të cilat do të munden të jenë në pronësinë e tyre personale dhe punë të cilat do të munden të numërohen në pronësi të përbashkët.

Mësimdhënësi thekson atë se rezultatet e punës së tyre (krijimet personale, vizatimet, aplikacionet etj) janë pronë e tyre dhe nuk duhet nxënësit tjerë t’i përvetësojnë (ajo punë quhet pronësi intelektuale).

Nxënësit përgatiten për aktivitetin e rradhës. Ndahen në grupe varësisht nga numri i nxënësve në klasë. Mësimdhënësi paraprakisht ka përgatitur kartela në të cilat ka vizatuar apo në formë të shkruar gjësende të pronësisë personale apo të përbashkët. Ata në zarfë ua ndan grupeve.

Mësimdhënësi paraprakisht ka vizatuar në hamer ndërsa mund edhe bashkërisht me nxënësit të vizatojnë t – tabelë në të cilën do të prezantohen dy kolona me tituj: pronësia personale – pronë e përbashkët.

<b>Prona personale</b>	<b>Prona e përbashkët (grupore)</b>

Shembull në t-tabelë

Kartelat me aplikacione me gjëra personale dhe nga prona e përbashkët nxënësit duhet t’i parashtrojnë në t- tabelën e theksuar më lartë ku bëjnë pjesë.

Ndërmjet aplikacioneve të ofruara me gjëra mund të ketë punë të llojit libri, kartuçi me vjersha të nxënësve të paraleles, vizatime të nxënësve të paraleles, biblioteka, CD me këngë, përmbledhje poezishë me çka nxënësit do të diskutojnë me mësimdhënësit.

## **AKTIVITETE EVALUATIVE**

Në fund të aktivitetit mësimitdhënësi organizon kuiz me pyetje të përgatitura paraprakisht të llojit të pronës personale dhe të përbashkët, me qëllim të shqyrtojë se sa nxënës e kanë përvetësuar dhe kanë kuptuar nocionin pronësi dhe se sa dijnë të bëjnë dallim ndërmjet llojeve të ndryshme të pronësisë.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja e din se çka është pronësia;
- e din dhe bën dallim ndërmjet llojeve të ndryshme të pronës;
- numëron gjëra të pronës personale dhe sqaron se vallë nuk duhet t'i shfrytëzojnë personat tjerë;
- numëron gjëra që janë të përbashkëta në familje dhe në shkollë.

### **Shembulli i 8**

**Njësia mësimore:**Mënyrat e informimit.

### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja të njihet me mënyrat e ndryshme dhe mjete e përcjelljes së informatave.

### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja din mënyra të ndryshme të përcjelljes së informatave dhe mjetet e ndryshme të informimit.

**Metodat mësimore:**metoda e të folurit, metoda e demonstrimit, teksti.

**Materialet dhe mjetet mësimore:** fletë letre formati A4, gërshtë, kartela me aplikacione të gjësëndeve nga pronësia personale dhe e përbashkët dhe në hamer.

**Vendi i realizimit:** klasa.

**Vijimi i aktivitetit**



## **AKTIVITETET HYRËSE**

Mësimdhënësi i inkuadron nxënësit në aktivitet me atë që i motivon të japin stuhi ideshë për mënyrat e mundshme dhe mjetet e informimit (marrja e informatave) për ndodhit në vend dhe jashtë vendit.

Ai jep pasqyrë historike në zhvillimin e mjeteve të informimit (psh. Në të kaluarën informatat janë përcjellë ngadal sepse janë përcjell njeri pas njeriut).

## **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Nxënësit tregojnë se prej cilëve media më tepër marrin informata, që më tepër ju intereson ndërsa tregojnë dhe për mjetet e informimit që i shfrytëzojnë anëtarët e familjeve të tyre.

Nxënësit ndahen në grupe në pajtim me numrin në klasë. Secili grup merr për detyrë që të shkruaj për medin e caktuar (TV, radio, shtypin ditor, Internetin). Varësisht nga ajo për cilin medium do të shkruajnë duhet theksuar se cili është funksioni i asaj medie (psh.radioja, shtypi ditor, Interenti). Varësisht nga ajo se për cilën media do të shkruajnë duhet theksuar se cili është funksioni i asaj medie (psh. Radioja të na informojë, argëton me emisionet muzikore të na relaksojë etj) çfarë informata mund të merren nga ajo media në cilën mënyrë i pranojmë informatat (auditive, auditive – visuele) dhe cilët janë anët e saj pozitive.

Mësimdhënësi vëmendje të veçantë i kushton përdorimit të Internetit si mjet informimi. E thekson nevojën për vëmendje të madhe gjatë shfrytëzimit të saj. Interenti përveç që informon, ofron mundëi edhe për aktivitetet tjera. Mësimdhënësi ven theks të veçantë në shfrytëzimin e rrjeteve sociale madje duke e theksuar rrezikun me të cilin munden të ballafaqohen nëse lënë të dhëna personale të tyre por gjithashtu rreziku i vënies kontakt me persona të panjohur.

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Në fund të aktivitetit mësimdhënësi dhe nxënësit diskutojnë për mënyrat e ndryshme të informimit, për anët e tyre pozitive si dhe për përdorimin e drejtë të Internetit si mjet më bashkëkohor për komunikim. Nxënësit grupohen në grupe sipas asaj se cili medium dhe pse është më tërheqës.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja din mjete të ndryshme për përcjelljen e informatave (radioja, televizioni, gazetatat ditore, Interneti);

- kupton se pse nevojitet përcjellja e informatave;
- bën dallim në mënyrën e përcjelljes së informatave;
- e di se cilët janë anët pozitive por edhe rreziqet e përdorimit joadekuat të Internetit.

## **TEMA2: VENDBANIME DHE LAGJE**

### **Shembulli 1**

#### **Njësia mësimore:Vendbanimi**

#### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja ta dallojë funksionin e vendbanimit të njerëzve dhe nevoja e kujdesit për atë.

#### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja e din fundkionin themelor të vendbanimeve të njerëzve;
- e di se njerëzit duhet kujdesur për vendbanimet e tyre.

**Metodat mësimore:**metoda e të folurit, metoda e demonstrimit, teksti.

**Materialet dhe mjetet mësimore:** fletë letre, letër formati A3.

**Vendi i realizimit:** klasë.

#### **Vijimi i aktivitetit**

### **AKTIVITETET HYRËSE**

Ora fillon me përsëritjen e shkurtër të asaj që është mësuar paraprakisht: rruga, lagja, banesa shtëpia, numri çift/tek, numri i vendbanimit, rendi shtëpiak.

Parashtrihen pyetje për atë se në çfarë objekte mund të jetojnë njerëzit dhe cilët janë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre.

### **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Mësimdhënësi bisedon me nxënësit për atë se çka do të ndodhte nëse njerëzit nuk kujdesen për vendbanimet e tyre dhe në cilën mënyrë fëmijët mund të inkuadrohen në kujdesin e mirëmbajtjes së higjienës dhe rendit të shtëpisë apo banesës në të cilën jetojnë.

Madje i jepet fletë mësimore „Hulumtim” dhe ju jepen udhëzime për plotësimin e saj me çka formohen grupet (3,4,5) varësisht nga numri i nxënësve. Secili grup fiton rezultate, i krahason dhe i fut në tabelën që do ta krijojë. (Mund të krijojë edhe tabelë të njejtë për tërë paralelen)

Pas mbarimit të aktiviteteve vijon prezantimi i konkluzave të fituara nga anëtarët e grupit.

### **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Sjellja e konkluzave dhe qëndrimeve të përbashkëta të të gjithë nxënësve të paraleles.

#### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja mund t'i numërojë karakteristikat themelore të vendbanimeve;
- di të dhëna për përcaktimin e vendbanimit (banesë apo shtëpi);
- sqaron se çka është rruga, lagja, banesa, shtëpia, numri çift/tek i vendbanimit, adresa;
- thekson arsye vallë pse njerëzit duhet të kujdesen për vendbanimet e tyre;
- mund të theksohet shembull se si fëmijët përfshihen në mirëmbajtjen e higjienës dhe rendin në vendbanim.

### **Fletë pune**

**Emri e mbiemri:** \_\_\_\_\_

Detyra 1

Bëje një hulumtim – Vallë numri më i madh i nxënësve në paralelen tuaj jetojnë në

anën e djathtë apo në anën e majtë të rrugës?

\*Ana e majtë:

\*Ana e djathtë:

Prej gjithsej \_\_\_\_\_ nxënës, në anën e djathtë të rrugës jetojnë \_\_\_\_\_, ndërsa në anën e majtë \_\_\_\_\_.

\*Unë jetoj në rrugën:

---

Detyra 2

Për të arritur, nga shtëpia deri në shkollë më nevojitet kohë prej \_\_\_\_\_ minuta.

Detyra 3

Shkruaje adresën e vendbanimit.

---

Detyra 4

Sa nxënës të paraleles jetojnë në shtëpi, sa në banesa ose diku tjetër?

---

Detyra 5

Pse duhet të mirëmbahen vendbanimet e njerëzve?

---

Detyra 6

Sa nxënësit e paraleles dhe në çfarë mënyre inkuadrohen në mirëmbajtjen e higjienës dhe rendit në vendbanimin e tyre?

---

## **Shembulli 2.**

**Njësia mësimore:** Fqinjësi dhe marrëdhënie fqinjësore

### **Qëllimet:**

- nxënësi/nxënësja ta kuptojë rëndësinë e fqinjëve në jetë;
- të mësojë se duhet të ruhen marrëdhëniet e mira ndërmjet fqinjëve.

### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja di se duhet të silllet në mënyrë të kulturuar me fqinjët;
- e kupton rëndësinë e fqinjëve në jetë.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e lojës, metoda e demonstrimit, metoda e tekstit.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** mjetet për të shkruar dhe vizatuar, top nga letra ose top i butë – i cili do të paraqet „gurin“.

**Vendi i realizimit:** klasë.

**Vijimi i aktivitetit**

## **AKTIVITETET HYRËSE**

Nxënësit qëndrojnë në rreth. Lojën e fillon mësuesi i cili në dorë mbanë topin nga letra, thotë një fjalë që ka të bëjë me nocionin fqinjët dhe ia dorëzon topin - „gurin që flet“ nxënësit pranë tij. Nxënësi thotë një fjalë tjetër që ka të bëjë me nocionin fqinjët, dhe ia dorëzon topin nxënësit pranë tij. Loja vazhdon përderisa çdo nxënës nuk thotë një fjalë. Me rëndësi është që fjala e njëjtë të mos përsëritet dy herë (shoqërim, huazim, përsëritje etj.).

## **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Mësuesi zhvillon bisedë me nxënësit duke parashtruar pyetje që kanë të bëjnë me jetën e njerëzve në një ndërtesë, mëhallë, si dhe për njerëzit dhe familjet që jetojnë në afërsi të tyre.

Pas bisedës arrihet përfundimi se njerëzit të cilët jetojnë afër familjeve tona janë fqinjë tanë.

Mësuesi parashtron pyetje të ndryshme, psh: Si veprojnë prindërit ndaj fqinjëve? Si veprojnë fqinjët ndaj prindërve dhe fëmijëve? Si duhet të veprojnë fëmijët ndaj fqinjëve? Çka nuk iu pëlqen në sjelljen e fqinjëve? Pse duhet mirë të sillemi me fqinjët? Si mund të ndihmohen fqinjët mes tyre?

Pas bisedës bashkërisht nxirret përfundimi se ndaj fqinjëve duhet të sillemi mirë dhe fqinjët duhet të ndihmohen.

Vijon biseda e mësuesit për atë çka është mëhalla, cilat mëhalla janë në vendbanimin e tyre, si quhen mëhallat, si i kanë marrë emrat e tyre, a njihni njerëz që jetojnë në ato mëhalla/lagje etj. Mësuesi mund të elaborojë edhe nga përvoja e tij e fëmijërisë për mëhallat/lagjet që kanë ekzistuar atë kohë. Në atë mënyrë nxënësit do të kuptojnë se mëhalla është pjesë e vendbanimit.

Mësuesi i pyet fëmijët që jetojnë në ndërtesë vallë dinë cilat janë rregullat e sjelljes në ndërtesën e tyre, sa banorët dhe fëmijët të cilët jetojnë në ndërtesë kolektive i respektojnë ato rregulla, pse duhet të respektohet rendi i shtëpisë dhe çka ndodh nëse ai nuk respektohet.


Nxënësit ndahen në disa grupe dhe secili grup duhet të shkruajë si duhet të sillen në mënyrë të kulturuar ndaj fqinjëve, pse dhe si mund të ndihmohen fqinjët e ndërtesës kolektive ose fqinjët e mëhallave/lagjeve (psh., njerëzit e shtyrë në moshë,

personat me hendikep, fëmijët e vegjël etj.).

Pas punës në grupe vijon prezantimi para nxënësve tjerë të paraleles, ndërsa mësimsdhënësi i inkurajon të nxjerrin përfundimin për nevojën dhe mënyrat e ruajtjes të marrëdhënieve të mira ndaj fqinjëve.

## AKTIVITETET EVALUATIVE

Nxënësit e plotësojnë fletën e punës.



### Fletë pune

#### Kriteret e vlerësimit:

- nxënësi/nxënësja di se duhet të veprojë në mënyrë të kulturuar me fqinjët dhe thekson shembuj konkret për këtë;
- jep shembuj për rëndësinë e fqinjësisë në jetë;
- sqaron pse duhet të respektohet rendi shtëpiak në ndërtesat kolektive;
- jep shembuj të raporteve të mira midis fqinjëve.

#### Shembulli 3

**Njësia mësimore:** Faktorët natyrorë dhe jeta në lagje

#### Qëllimi:

- nxënësi/nxënësja ta njohë relievin e lagjes dhe mjedisit për rreth.

#### Rezultatet e pritura:

- nxënësi/nxënësja e kupton nocionin reliev.

**Metodat mësimore:** metoda e demonstrimit, metoda e të folurit, metoda e hulumtimit, metoda e punës praktike.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** relievi dhe harta gjeografike e Republikës së Maqedonisë, veglat për shkrim dhe vizatim, kutia - „akuarium”.

**Vendi i realizimit:** mjedisi i drejtpërdrejtë, klasë.

Para realizimit të kësaj njësie mësimore mirë është të realizohet vëzhgimi paraprak i mjedisit të drejtpërdrejtë që të vëzhgohet relievi në natyrë, që pastaj të tejkalohet në relievin në hartë. Shkrimleximi hartografik i nxënësve duhet të realizohet në mënyrë sistematike dhe gradualisht – të respektohen rregullat didaktike të shkohet nga konkretja kah abstraktja, të fillohet nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë i relievit në mjedisin e afërt, pastaj të vizatohet, përpunohet një hartë e rajonit të tij/saj të lindjes.

**Vijimi i orës**

## AKTIVITETET HYRËSE

Mësimdhënësi i ndanë nxënësit në dy grupe sipas rastit duke nxjerrë shkopinjtë druri me emrat e nxënësve.

Ata marrin detyrë të zbulojnë nocione që kanë të bëjnë me mësimin e ri.

Ato përbëhen nga një fjalë.

1	2	3	4	5	6	7
K	O	D	R	I	N	A
1	2	3	4	5	6	7
L	I	Q	E	N	E	T

Loja luhet në dy grupe.

Një nxënës, të cilin do ta përzgjedh grupi, thotë një numër, mësimdhënësi e thotë shkronjën nën atë numër. Pastaj saktëson cila është fjala. Nëse nuk e di, atëherë nxënësi i grupit tjetër thotë numër dhe qëllon nëse e di cila është fjala. Kështu vijon përdërisa ndonjëri nga nxënësit nuk e zbulon fjalën.

## **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Paralajmërohet qëllimi i orës.: njoftimi i nxënësve me pamjen e tokës në mjedisin e afërt. Dalin në oborrin e shkollës dhe mësimdhënësi i inkurajon në vëzhgimin e udhëzuar me qëllim që të shohin në çfarë toke gjendet vendbanimi i tyre (rrafshnaltë, malore, kodrinore), ajo që ndodhet në mjedisin e afërt (psh: lum, përrua, burim, liqene).

Pas kthimit në klasë nxënësit e vëzhgojnë relievin në hartën e Republikës së Maqedonisë, e gjejnë vendbanimin e tyre, shikojnë ku ka më shumë male, rrafshnalta, kodrina, liqene, lumenjë dhe në afërsi të cilave vende ndodhen ato.

Përmes bisedës nxënësit përkujtohen edhe në vizitën e bërë në mjedisin e afërt, më pas mësimdhënësi tregon se të gjitha ato rrafshnalta, kodrina dhe male, e gjithë pamja e jashtme e sipërfaqes së Tokës quhet reliev.

Nxënësit në një cope letre shkruajnë nga një pyetje lidhur me temën e cila punohet në orë, çka nuk e kanë të qartë ose dëshirojnë diçka të dinë në mënyrë plotësuese. Pyetjet e tyre i vendosin në një kuti të cilën paraprakisht e kanë përgatitur - „akuarium”. Prej aty mësimdhënësi tërheq disa pyetje, ndërsa përgjigjen e tyre e kërkon nga nxënësit. Në qoftë se ata nuk i dinë përgjigjet, mësimdhënësi iu përgjigjet pyetjeve të njëjta.

Ai e tregon hartën gjeografike të Republikës së Maqedonisë dhe i fton nxënësit në hartë ta gjejnë vendin e tyre. Në grupe më të vogla të gjithë nxënësit dalin dhe e tregojnë vendbanimin e tyre.

Në të njëjtën kohë ata shohin se si në këtë hartë, përkatësisht me cilat ngjyra janë përfaqësuar malet, rrafshnaltat, kodrinat, liqenet dhe lumenjtë. që do të thotë, cilat ngjyra përfaqësojnë malet, fushat, kodrat, liqenet dhe lumenjtë.

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Nxënësit në hartat e tyre të vogla të Republikës së Maqedonisë i tregojnë pjesët që i përfaqësojnë malet, rrafshnaltat, lumenjtë etj.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja e kupton nocionin reliev;
- di të gjejë vendbanimin e vet në hartën gjeografike;
- i di nocionet mal dhe rrafshnalët;
- di me cilat ngjyra në hartën gjeografike janë paraqitur malet, rrafshnaltat, kodrinat, liqenet.

**Detyrë shtëpie:** Nxënësve iu jepet detyrë ta gjejnë vendbanimin e tyre në google maps.

## **Shembulli 4**





## AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES

Mësimdhënësi e tregon hartën gjeografike të Republikës së Maqedonisë dhe i pyetë ku ndodhet vendbanimi i tyre (fshat, qytet) komuna e tyre. Ata përkujtohen në atë që kanë mësuar më herët dhe disa prej tyre e tregojnë vendbanimin e tyre.

Mësimdhënësi në hartën gjeografike të Republikës së Maqedonisë i tregon anët e botës.



Disa nxënës tregojnë në hartën e madhe të relievit ku ndodhet lindja, perëndimi, veriu dhe jugu.

Nxënësit me tërheqjen e fletëzave të shënuara me numra prej 1 deri 4 grupohen në katër grupe. Secili grup merr një hartë të vogël gjeografike të Republikës së Maqedonisë dhe detyrë që mirë ta shikojë hartën dhe t'i rrethojë me laps qytetet në Republikën e Maqedonisë të cilët gjenden në anën e caktuar të botës (lindje, perëndim, veri dhe jug). Pas përfundimit të punës secili grup prezanton (psh., në veri gjendet Shkupi, Kumanova...), nxënësit tjerë kontrollojnë në hartat e tyre dhe me karton të gjelbër ose të kuq tregojnë vallë sipas tyre përgjigja është e saktë ose e pasaktë.

## AKTIVITETET EVALUATIVE

Çdo nxënës merr fletë për kontrollimin e njohurisë të cilën individualisht duhet ta plotësojë dhe ta dorëzojë te mësimdhënësi.

### Kriteret e vlerësimit:

nxënësi/nxënësja di t'i caktojë anët e botës në hartën gjeografike të Republikës së

Maqedonisë;


- di të caktojë në cilën anë të botës ndodhet klasa në shkollën e tij/saj;

- mund të gjejë në cilën anë në hartën e Republikës së Maqedonisë gjenden qytetet më të mëdha.

## Fletë pune

Emri e mbiemri: \_\_\_\_\_

1. Cakto në hartë anët e botës.



2. Në cilën anë të hartës së Republikës së Maqedonisë gjenden qytetet: Koçani, Vinicë dhe Berovë?

\_\_\_\_\_

3. Në cilën anë të hartës së Republikës së Maqedonisë gjendet qyteti i Shkupit dhe Kumanovës?

\_\_\_\_\_

4. Në cilën anë të hartës së Republikës së Maqedonisë gjendet qyteti i Dibrës?

\_\_\_\_\_

5. Në cilën anë të hartës së Republikës së Maqedonisë gjendet qyteti i Gjevgjelisë?

---

### **Shembulli 5**

**Njësia mësimore:** Harta gjeografike

#### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja të përvetësojë njohuri për nocionin hartë gjeografike dhe për leximin elementar të hartës gjeografike të Republikës së Maqedonisë.

#### **Rzultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja di çka është harta gjeografike dhe çka paraqesin ngjyrat në të.

**Metodat mësimore:** metoda e demonstrimit, metoda e të folurit, metoda e hulumtimit, metoda e punës praktike.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** hartë memece, ngjyra druri, ngjitës, fleta të bardha si bazë për ngjitjen e pjesëve të radhitëses.

**Vendi i realizimit:** klasë.

### **Vijimi i aktivitetit**

#### **AKTIVITETET HYRËSE**

Nxënësit ndahen në grupe në bazë të numrit të tyre në paralele.

Mësimdhënësi iu ndanë zarf në të cilin ka pjesë nga radhitësja të cilën ata duhet ta bashkangjesin/radhisin.

Pasi ta radhisin radhitësen ata marrin një fotografi të hartës gjeografike të Republikës së Maqedonisë.

#### **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Mësimdhënësi sqaron çka paraqet harta gjeografike dhe çka është prezantuar në të. Ai, gjithashtu tregon se ngjyrat hartografike dhe shenjat hartografike janë të nevojshme për leximin e hartës gjeografike.

Më pas i inkurajon nxënësit të mendojnë pse pjesë të ndryshme të hartës gjeografike janë prezantuar me ngjyra të ndryshme.

Ata iu përgjigjen pyetjeve të parashtruara nga mësimdhënësi.


Mësimdhënësi sqaron dhe njëkohësisht tregon se relievi i hartës gjeografike paraqitet me ngjyra hartografike (me ngjyrë kafeje shënohen malet, me ngjyrë të verdhë kodrinat, me ngjyrë të gjelbër ultësitrat dhe me ngjyrë të kaltër ujërat).

Pastaj mësimdhënësi iu sqaron nxënësve çka është paraqitur dhe çka paraqesin disa nga të dhënat në hartën gjeografike (emrin e shtetit, legjendën me shenjat hartografike dhe shkallën e lartësisë të ngjyrave sipas lartësisë mbidetare të maleve).

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Nxënësit marrin fleta pune me pyetje në lidhje me përmbajtjen e re mësimore që të kontrollohen njohuritë e fituara për hartën gjeografike. Ata punojnë në mënyrë të pavarur.

RADHITËSE – HARTA GJEOGRAFIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



## Fletë pune

Emri e mbiemri: \_\_\_\_\_

Fletë pune	
1. Çfarë tregohet në hartën gjeografike të Republikës së Maqedonisë?	
_____	
2. Si janë radhitur anët kryesore të botës në hartën gjeografike?	
Veriu është _____.	Jugu është _____.
Perëndimi është _____.	Lindja është _____.
3. Plotësoji fjalitë.	
Ngjyra kafeje i përcakton _____.	
Ngjyra e verdhë i përcakton _____.	
Ngjyra e kaltërt i përcakton _____.	
Ngjyra e gjelbër i përcakton _____.	

### Kriteret e vlerësimit:

- nxënësi/nxënësja di çka është harta gjeografike;
- di çka i përcakton ngjyrat në hartën gjeografike;
- i ndërlidhë ngjyrat në hartën gjeografike me nocionet: mal, ultësirë, kodrinë, liqe.

**Detyrë shtëpie:** Nxënësit kanë detyrë që në hartë memece të përpiqen me ngjyrat hartografike ta prezantojnë relievin e Republikës së Maqedonisë dhe t'i shkruajnë anët kryesore të botës.

## **Shembulli 6:**

**Njësia mësimore:** Shenjat hartografike

### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja të fitojë njohuri për shenjat hartografike dhe dedikimi i tyre.

### **Rezultati i prituri:**

- nxënësi/nxënësja njih disa nga shenjat hartografike dhe e di kuptimin e tyre.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e punës praktike, metoda e demonstrimit.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** laps, aplikacione me shenja hartografike, fleta mësimore në të cilat janë dhënë shenjat hartografike, flomasterë, ngjyra druri, hamer.

**Vendi i realizimit:** klasë.

### **Vijimi i orës**

#### **AKTIVITETET HYRËSE**

Në këtë pjesë të orës përsëritet ajo që është mësuar paraprakisht për hartën gjeografike. Nxënësit në hartën gjeografike i tregojnë, përkatësisht i përcaktojnë anët e botës dhe sqarojnë për kuptimin e ngjyrave hartografike.

Mandej nxënësit udhëzohen t'i gjejnë qytetet më të mëdha në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, udhëzohen edhe të vërejnë çfarë shenje qëndron pranë emrit të qytetit (pastaj vërejnë se shenjat dallohen varësisht nga numri i banorëve të qytetit konkret). Pasi t'i gjejnë dhe t'i përshkruajnë shenjat, nxënësit përsëri udhëzohen të kërkojnë shenja tjera të cilat janë në hartën gjeografike të Republikës së Maqedonisë (psh., kufiri shtetëror, aeroporti etj.)

Nxënësit punojnë në çifte. Pasi të kenë hasur ndonjë nga shenjat, ata i përshkruajnë dhe në qoftë se ndonjëri prej tyre e di kuptimin e tyre e tregon.

#### **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Nxënësve iu theksohet qëllimi i orës: se do të mësojnë për shenjat hartografike dhe se shenjat që i kanë hasur në hartën gjeografike, në fakt janë shenja hartografike.

Pastaj iu sqarohet se për lexim më të lehtë të hartës gjeografike duhet të njihen edhe shenjat hartografike.

Mësimdhënësi e sqaron kuptimin e disa shenjave hartografike.

(Gjatë sqarimit ai mund t'iu ndajë nxënësve fleta mësimore në të cilat janë dhënë shenjat hartografike, ndërsa nxënësit pranë secilës shenje hartografike të shkruajnë kuptimin e tyre.)



Si aktivitet vijues mësimdhënësi iu jep për detyrë të përpunojnë në çifte aplikacione me shenja hartografike të cilat pastaj do të duhet t'i vendosin në hartë. Nxënësit midis tyre merren vesh cilat shenja hartografike t'i përpunojnë dhe më pas t'i vizatojnë.

Pasi të përfundojnë me aplikacionet e shenjave hartografike, sipas kësaj ku ndodhen ato shenja në hartën gjeografike të Republikës së Maqedonisë, i parashtrojnë në hartën memece të Republikës së Maqedonisë. Kështu secili çift nxënësish përpunon hartë me shenja hartografike.

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Në këtë pjesë të orës disa nga çiftet prezantojnë cilat shenja hartografike i kanë përpunuar dhe i kanë vendosur në hartën memece. Pastaj të njëjtat mund të vendosen në panoa të shkollës.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja njih disa nga shenjat hartografike në hartën e Republikës së Maqedonisë;
- numëron disa shenja hartografike;
- mund ta sqarojë kuptimin e disa shenjave hartografike;
- di se me njohjen e shenjave hartografike mund të lexohet harta gjeografike.

## **TEMA 3: KOMUNA**

### **Shembulli 1**

**Njësia mësimore:** Tradita në komunë

### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja të inkurajohen për t'i ruajtur traditat e bashkësisë lokale.

### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja e kupton nocionin traditë;
- di disa tradita në bashkësinë lokale.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, tekst metoda, metoda hulumtuese.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** fletë A4, laps, fotografi, tekste, hamer, Internet.

**Vendi i realizimit:** klasë.

**Vijimi i orës:**

## **AKTIVITETET HYRËSE**

Mësimdhënësi në fillim të orës i përkujton gjatë bisedës për atë çka është kultura dhe çka ngërthen ajo në vete (arti, tradita, zakonet, shprehitë etj).

Mësimdhënësi në tabelë e shkruan fjalën TRADITË. I pyetë nxënësit përmes teknikës stuhi idesh të tregojnë çka kuptojnë me nocionin traditë, kur e kanë dëgjuar fjalën, çfarë kuptimi ka, të sqarojnë pse shpesh themi: „Kjo është tradita jonë”.

Bashkërisht nxirret përfundimi se tradita është zakon, mënyrë e sjelljes, festimi në familje dhe në mjedisin lokal, që transmetohet nga brezi në brez.

## **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Mësimdhënësi i lexon një nga proverbat në vijim:

BUKA ME MJALTË, DORA ME BALTË.

BUKA PO U THYE S'NGJITET MË.

BUKË E KRIPË E ZEMËR.

BUKA PA THARM NUK ËSHTË BUKË.

Nxënësit në çifte debatojnë për proverbat, njëherit përpigjen t'i ndërlidhin me situata nga përditshmëria.

Thirren katër çifte për t'i treguar mendimet e tyre, ndërsa nxënësit tjerë të plotësojnë, nëse kanë mendim më ndryshe dhe më interesant. Nxënësit tregojnë edhe proverba tjerë të cilat i dinë. Nxirret përfundimi se edhe proverbat përcillen nga gjenerata në gjeneratë.

Me nxënësit bisedohet për traditën në familje, ndërlidhur me ndonjë ngjarje dhe festë: dasma, lindja e fëmijës, festë shtëpie, tradita, festat si: (Pashkët, Kërshëndellat, Festa e faljes, Fitër Bajrami). Biseda vazhdon në lidhje me ushqimet tradicionale (japarak, lakror, bakllavë, nazlifatma), muzikën tradicionale, përrallat tradicionale të cilat nxënësit i kanë mësuar nga prindërit e tyre, gjyshi, gjyshja, miq dhe familjarë tjerë.

Vijon puna në grupe. Me ndihmën e kompjuterit nxënësit hulumtojnë në Internet. Nëse nuk kanë Internet ata, në bazë të marrëveshjes paraprake kanë dhënë prerje të fotografive, teksteve, incizimeve dhe ngjashëm për aktivitetin e planifikuar. Grupet marrin detyra konkrete:

1. Grupi i parë hulumton për festat dhe manifestimet tradicionale.
2. Grupi i dytë hulumton për muzikën tradicionale.
3. Grupi i tretë hulumton për veshmbathjen tradicionale.
4. Grupi i katërt hulumton për ushqimet tradicionale.

Në nivel të paraleles secili grup i prezanton rezultatet nga hulumtimet e tyre, duke prezantuar traditat në mjedisin lokal.

Pas prezantimeve mësimdhënësi i inkurajon nxënësit të nxjerrin përfundim të përbashkët. Secila familje dhe çdo popull ka traditën e vet. Traditat e familjeve të ndryshme edhe të popujve të ndryshëm duhet të njihen dhe të respektohen.

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Detyrë individuale për kontrollim:

Përmes teknikës 321 çdo nxënës/nxënëse duhet të shkruaj:

- tre ushqime tradicionale;
- dy fjalë të urta popullore;
- një këngë popullore.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja e kupton nocionin traditë;
- di disa tradita të mjedisit të vet lokal;
- gjen ngjashmëri dhe dallime në festat tradicionale, veshmbathjen dhe ushqimet në kulturat e ndryshme të bashkësisë lokale;
- tregon shembuj si mund të ruhen traditat në bashkësinë lokale.

### **Shembulli 2**

**Njësia mësimore:** Bashkësia lokale dhe vetëqeverisja lokale

*Për realizimin e këtij planifikimi nevojiten dy orë mësimore.*

### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja t'i përvetësojë njohuritë elementare për vetëqeverisjen lokale.

### **Rezultati i pritur:**

- nxënësi/nxënësja ka njohuri elementare për vetëqeverisjen lokale.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e vëzhgimit, metoda e demonstrimit dhe metoda e hulumtimit.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** letra, lapasa, telefon celular për incizim.

**Vendi i realizimit:** klasë, komunë.

### **Vijimi i orës**

## **AKTIVITETET HYRËSE**

Mësimdhënësi i përkujton nxënësit për njohuritë e përvetësuara nga ora paraprake, mandej i informon se ka caktuar takim me kryetarin e komunës dhe me përfaqësues

të këshillit të komunës. Nxënësit janë qytetarë të komunës, kështu që mësimdhënësi i lut të mendojnë çka është e nevojshme për rrugën e tyre, për shkollën e tyre dhe oborrin e shkollës, që ta kenë më mirë dhe më bukur. Përmes stuhi ideve nxënësit sugjerojnë propozime të cilat mësimdhënësi i shkruan në tabelë.

## **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Mësimdhënësi kërkon që nxënësit në bazë të interesave të tyre të ndahen në katër grupe. Grupi i parë do të shkruajë një tekst të shkurtë rreth propozimeve të tyre për përmirësimin e kushteve në klasë, shkollë dhe oborrin e shkollës; grupi i dytë duhet të përpilojë pyetje për atë se cilat janë detyrat kryesore dhe obligimet e kryetarit të komunës; grupi i tretë duhet të përpilojë pyetje për atë se cilat janë detyrat dhe obligimet kryesore të këshillit të komunës, ndërsa grupi i katërt duhet t'i fotografojë stemën dhe flamurin e komunës.

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Përfaqësuesit e tre grupeve e lexojnë para paraleles atë që e kanë shkruar (propozimet për përmirësimin e kushteve në klasë, shkollë dhe oborrin e shkollës, pyetjet për detyrat dhe obligimet kryesore të kryetarit të komunës dhe pyetjet për detyrat dhe obligimet e këshillit të komunës), ndërsa nxënësit tjerë, nëse dëshirojnë, propozojnë plotësimin e asaj që është shkruar.

Në orën e ardhshme nxënësit do ta realizojnë vizitën e planifikuar në komunë dhe atëherë do t'i realizojnë detyrat e planifikuara. Pas kthimit në shkollë secili grup i prezanton rezultatet para gjithë paraleles: informatat që i kanë marrë lidhur me propozimet e tyre, atë që e kanë mësuar për punën e kryetarit të komunës; këshillin e komunës, si dhe përshkrimin e stemës dhe flamurit të komunës.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja njih disa nga detyrat dhe obligimet e kryetarit të komunës në vetëqeverisjen lokale;
- njih disa nga detyrat dhe obligimet e këshillit të komunës;
- di se qytetarët realizojnë të drejtat në vetëqeverisjen lokale;
- di pamjen e stemës dhe flamurit të komunës;
- mund t'i identifikojë nevojat si nxënës në shkollë dhe qytetar në komunë.

### **Shembulli 3**

**Njësia mësimore:** Organet e komunës

### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja të njihet me organet e komunës.

### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja di se cilat janë organet e komunës.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e hulumtimit, metoda e demonstrimit.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** laptopa, fletëza për votim, kuti.

**Vendi i realizimit:** klasë.

**Vijimi i orës**

### **AKTIVITETET HULUMTUESE**

Mësimdhënësit përmes pyetjeve zhvillon bisedë për materialin e mësuar paraprakisht në lidhje me atë çka është komuna, në cilin rajon bën pjesë, cilat komuna tjera i njihni.

### **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Mësimdhënësi në tabelë vizaton një rreth the iu thotë nxënësve të imagjinojnë sikur është komuna. Në brendinë e rrethit paraqiten dy rrethë më të vegjël: me vijë të kuqe – këshilli i komunës, me vijë të kaltërt – kryetari i komunës. Mësimdhënësi iu tregon nxënësve se do të njoftohen me: organet e komunës, këshillin e komunës dhe kryetarin e komunës.

Pastaj përmes bisedës me nxënësit ata njoftohen me atë se kush e përbën këshillin e komunës dhe si funksionon, mandej si bëhet përzgjedhja e kryetarit të komunës dhe cili është roli i tij.

#### **Organet e komunës**

Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që të hapin ueb - faqen e komunës në të cilën jetojnë (për shembull: <http://www.struga.gov.mk>), më saktë faqja në të cilën janë paraqitur të gjitha obligimet të cilat i kryen kryetari i komunës dhe këshilli i komunës dhe të njëjtat ua sqaron nxënësve në mënyrën më të kapshme për moshën e tyre.

Vijon puna hulumtuese në grupe në Internet ku nxënësit i gjejnë informatat e nevojshme, për t'i kuptuar më mirë obligimet e organeve të komunës.

Lexohen përgjigjet nga të gjitha grupet dhe bëhet krahasimi, ndërsa sipas nevojës bëhet edhe plotësimi.

### **AKTIVITETET EVALUATIVE**

**Loja simuluese**

Nxënësit me votim të fshehtë zgjedhin përfaqësuesit e qytetarëve të cilët do ta përbëjnë këshillin, si dhe kryetarin e komunës.

Pastaj nga radhët e këshillit zgjedhin kryetarin.

Simulimi: caktimi i mbledhjes nga kryetari, ndërsa një nxënës mban procesverbalin.

Pastaj këshilli zgjidh një problem në interes të nxënësve dhe sjell vendim si ai të zgjidhet dhe me këtë të përmirësohet jeta e nxënësve në shkollë.

Kryetari i komunës është i detyruar për ta realizuar atë vendim. Njëkohësisht kryetari i komunës përcakton ditë pranimi për nxënësit, ndërsa ata i informojnë për problemet të cilat i kanë dhe japin ide si të zgjidhen.

Më pas zhvillohet bisedë për të gjitha fazat nga simulimi i punës në organet e këshillit të komunës.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja emëron organe të komunës;
- di kush e përbën këshillin e komunës dhe si funksionon;
- di si zgjedhet kryetari i komunës dhe cili është roli i tij.

### **Shembulli 4**

#### **Njësia mësimore – Veprimtaritë komunale**

#### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja të njihet me veprimtaritë komunale të bashkësisë lokale.

#### **Rezultati i pritur:**

- nxënësi/nxënësja di për rolin e shërbimit të veprimtarive komunale.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e punës praktike.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** laps, flomasterë, ngjyra druri, hamer.

**Vendi i realizimit:** klasë.

### **Vijimi i orës**

#### **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit në aktivitet me parashtrimin e pyetjeve: Çka kuptoni me nocionin mjedis i pastër? Vallë e dini kush kujdeset për pastërtinë e qytetit tonë?

Nxënësit në letër duhet të shkruajnë së paku tre punë me temë „Mjedis i pastër“, përkatësisht për atë çka paraqet mjedisi i pastër për ato. I lexojnë mendimet e tyre për ambientin e pastër. Mësimdhënësi zhvillon bisedë me nxënësit për atë se kush duhet përkujdesur për mjedisin tonë të pastër.

Parashtron pyetje: Çka mendoni, kush duhet të pastrojë shportat e mbeturinave, bërllokun, rrugët, lumenjtë dhe parqet? Ku qytetarët e komunës duhet të hedhin

mbeturinat dhe në cilën periudhë të ditës?

Mësimdhënësi sqaron se në komuna ekziston shërbimi për veprimtari komunale i cili kujdeset që mjedisi ynë të jetë i pastër.

## **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Mësimdhënësi në tabelë shkruan titullin: „Veprimtaritë komunale”.

Ai sqaron cili është roli i shërbimit për veprimtari komunale, për atë se kujdeset për pastërtinë e rrugëve, parqeve, tregjeve, për mirëmbajtjen e shtratit të lumit dhe për pastrimin e dëborës nga rrugët gjatë periudhës së dimrit me mekanizëm përkatës dhe automjete speciale të pajisura.

Mësimdhënësi iu parashton pyetje nxënësve për atë ku shërbimi për veprimtari komunale e dërgon bërllokun. Nxënësit përgjigjen, njëherit edhe mësimdhënësi bën sqarime rreth vendit të deponisë dhe ku mund të ndodhet.

Ai kërkon nga nxënësit të mendojnë dhe të thonë se vallë ata mund të kontribuojnë për mjedis jetësor më të pastër dhe në çfarë mënyre.

Nxënësit shprehin mendimet e tyre pas pyetjes së parashtruar.

Pastaj ata ndahen në tre grupe dhe mësimdhënësi kërkon prej tyre të vizatojnë shenja ose të shkruajnë parrulla ose porosi me të cilat do ua bëjnë me dije qytetarëve të pandërgjegjshëm ku duhet hedhur mbeturinat, njëherit do t'i inkurajonin të mendojnë për ambient të shëndoshë dhe të pastër.

Grupi i parë i nxënësve duhet të vizatojnë shenja ose të shkruajë porosi për mirëmbajtjen e pastërtisë së rrugëve. (Psh.: Mos hedhni mbeturina nga automobilat tuaj)

Grupi i dytë i nxënësve duhet të vizatojë shenja ose të shkruajë porosi për parqet dhe terrenet sportive.

Grupi i tretë i nxënësve duhet të vizatojë shenja ose të shkruajë porosi si të mirëmbahen të pastra shkollat dhe oborret e shkollave.

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Përpunimet, shenjat dhe porositë e nxënësve ngjiten në një hamer me titull „Mjedis i pastër” dhe hameri vendoset në panënë e klasës, dhe më pas në korridorin e shkollës.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja di cili është roli i shërbimit për veprimtari komunale në komunë;
- ka qëndrim pozitiv ndaj ruajtjes të mjedisit të pastër në komunë.

- mund të propozojë aktivitete për një ambient jetësor më të pastër në komunë.

## **Shembulli 5**

**Njësia mësimore:** Problemet në komunën time

### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja të njihet me problemet e mundshme në komunë.

### **Rezultatet e pritura:**

- nxënësi/nxënësja mund të njihet me disa probleme në komunë.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e hulumtimit, metoda e demonstrimit.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** fleta të formatit A4, stylolaps, lapasa, flomastera.

**Vendi i realizimit:** klasë.

## **Vijimi i orës**

### **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Mësimdhënësi i njofton nxënësit me përmbajtjen të cilën do ta punojnë në orë dhe iu ndanë fleta në të cilat është shkruar teksti.

Mësimdhënësi e lexon tekstin.

### **QYTETI I GJELBËR**

Në zonën e afërt të qytetit të Gjelbër ka pasur një lëndinë të bukur. Ajo tërhiqte vëmendjen e secilit kalimtar rasti. Ishte një lëndinë e pazakonshme, edhe në verë por edhe në dimër ajo ishte e gjelbër, nuk e humbte ngjyrën, përveç asaj në të rriteshin edhe lulet më të bukura prej të cilave përhapej një aromë e këndshme.

Ishte parajsë e vërtetë dhe krenari të jesh banor i qytetit të Gjelbër. Megjithatë, një mëngjes qytetarët i zgjoi një aromë jo e këndshme që vinte nga lëndina e gjelbër. Papritmas u dëgjua sirenë alarmi. Të gjithë qytetarët e qytetit të Gjelbër u drejtuan në drejtimin nga vinte edhe tymi. Çka të shohin, lëndina e gjelbër kishte ndryshuar. E tëra ishte mbuluar me mbeturina, ndërsa në vendin e luleve të llojlojshme gjithandej kishte mbeturina të hedhura (ambalazhe të qumështit, shishe prej plastike dhe prej qelqi, letër, mbeturina ushqimesh e çka nuk kishte).

Qilimi i gjelbër ishte shndërruar në të zi, kurse lulet e llojlojshme ishin mbuluar me hiri gri nga edhe përhapej aroma kundërmuese.



Qyteti nuk ishte më i njëjtë, shkëlqimi i tij u shua dhe qytetarët ishin të dëshpëruar, shpejt filluan të sëmureshin dhe të largoheshin nga qyteti i gjelbër.

Kalimtarët e rastit shihnin sa më shpejtë të iknin nga qyteti në hyrjen e të cilit shkruante „Mirë se vini në qytetin më të ndotur“.

Mësimdhënësi inicion debatin dhe parashtron pyetje të llojit:

- Me çfarë problemi është ballafaquar qyteti i Gjelbër?
- Në çka u shndërrua lëndina e gjelbër?
- Kush është fajtori për një gjendje të tillë?
- Çka ka ndikuar deri te ajo gjendje?
- Si mund të zgjidhej problemi i mbeturinave?
- Çka mund të bënin qytetarët për qytetin e tyre?
- Vallë qytetarët janë aq të fuqishëm sa të zgjidhin problemin vetë ose është e nevojshme të përfshihen edhe disa njerëz tjerë, institucione? Cilat?

Pas debatit të gjerë rreth problemit me të cilin janë ballafaquar qytetarët e qytetit të Gjelbër dhe zgjidhjet e mundshme të problemit, parashtrohet pyetja për atë me çfarë probleme tjera mund të ballafaqohen banorët në vendbanimin e tyre.

Mësimdhënësi mund t'iu ndihmojë në detektimin e problemit, përveç problemit me mbeturinat, të mendojnë edhe për problemet me:

- numrin e madh e automjeteve në qytet dhe hapësirat e pamjaftueshme të parkingjeve;
- mungesën e hapësirave të mjaftueshme për lojë;
- mungesën e parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra;
- mbipopullimin, zhurmën etj.

## **AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES**

Mësimdhënësi i ndanë nxënësit në tre grupe (ose më shumë), në bazë të numrit të nxënësve në paralele dhe iu jep detyra:

- Grupi i parë të mendojë për problemin me ndotjen e qytetit, t'i theksojë shkaqet që mund të shpijnë deri te ndotja dhe të propozojë ide për zgjidhje të mundshme për tejkalimin e problemit me ndotjen.

- Grupi i dytë angazhohet për problemin me komunikacionin dhe të propozojë ide për zgjidhje të mundshme.

- Grupi i tretë mendon rreth problemit me zhurmën në qytet dhe të propozojë ide për zgjidhje të mundshme.

Pastaj secili grup prezanton konkluzat e tyre dhe cilat janë idetë e tyre për zgjidhjen e mundshme të problemeve me të cilat ballafaqohen vendbanimi i tyre.

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Vijon përfundimi i përbashkët që secili prej nesh jeton në ndonjë lagje. Banorët e një

lagje drejtpërdrejtë ballafaqohen me problemet të cilat krijohen në të. Ata duhet të jenë aktiv dhe qytetarë të ndërgjegjshëm për një angazhim drejt zgjidhjes së problemeve.

Për të arritur ndonjë qëllim, banorët duhet ta duan lagjen e tyre, të kenë respekt ndaj të gjithë qytetarëve, të jenë të vetëdijshëm për problemet dhe të njëjtat t'i zgjidhin në mënyrë të organizuar.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja di se në komunë paraqiten probleme të ndryshme dhe se të njëjtat kërkojnë zgjidhje;
- di kuptimin dhe rëndësinë e ambientit jetësor të pastër dhe të shëndetshëm;
- di cilat veprime të njerëzve në pikëpamje të ambientit jetësor nuk janë të mira;
- mund të propozojë zgjidhje të ndryshme për situatën problematike konkrete.

### **Shembulli 6**

**Njësia mësimore:** Jeta kulturore në komunë

#### **Qëllimi:**

- nxënësi/nxënësja ta kuptojë rolin e kulturës në jetën e bashkësisë lokale.

#### **Rezultati i pritur:**

- nxënësi/nxënësja e di kuptimin dhe rëndësinë e kulturës si pjesë përbërëse e jetës së njerëzve në bashkësinë lokale.

**Metodat mësimore:** metoda e të folurit, metoda e hulumtimit, metoda e demonstrimit.

**Mjetet mësimore dhe materialet:** fletë mësimore, fotografi të objekteve kulturore, fotografi nga manifestimet kulturore në komunë, fjalëkryq, kartuqe të formatit A4 për kopertinën e librit, lapsa, materiale për vizatim.

**Vendi i realizimit:** klasë.

#### **Vijimi i orës**

### **AKTIVITETET HYRËSE**

Në këtë pjesë të orës përdoret teknika „Fjalëkryq“ përmes së cilës nxënësit e zbulojnë nocionin kulturë.

## FJALËKRYQ

1.	K						
2.	U						
3.	L						
4.	T						
5.	U						
6.	R						
7.	A						

1. Bimë e gjelbër me gjemba.
2. Mbi të kalojnë automobila, kamionë, këmbësorë.
3. Lulëzimi i saj paralajmëron ardhjen e pranverës.
4. Me të fëmijët luajnë futboll, volejball dhe hendboll.
5. Për të flasim, hajmë.
6. Mjet informimi.
7. Mjeti për komunikacion ajror.

Mësimdhënësi i udhëzon të mendojnë çka kuptojnë me nocionin kulturë.

## AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES

Mësimdhënësi sqaron çka kuptojmë me nocionin kulturë. Kultura është mënyra e jetesës së një populli.

Kultura është e lidhur ngushtë me traditën dhe vlerat shpirtërore, e kjo reflektohet në artin, traditat dhe zakonet e popullit.

Mësimdhënësi iu sqaron nxënësve se çdo popull ka kulturën e vet dhe se kulturat e popujve dallohen midis tyre.

Për tejkalimin e dallimeve në kulturën midis njerëzve më e rëndësishme është të ketë respekt, komunikim, tolerancë dhe pranimi i tjetrit me dallimet e tij.

Mësimdhënësi thekson se organizimi i manifestimeve kulturore në një bashkësi lokale kanë rol të rëndësishëm në reciprocitetin e njerëzve.

Biseda vazhdon në lidhje me rolin e institucioneve kulturore në bashkësinë lokale.

Mësimdhënësi iu parashtroi pyetje të llojit:

- Ku mbahen shfaqjet teatrale?
- Vallë ndonjëri prej jush ka marrë pjesë në një shfaqje baleti dhe në cilën? Çka iu pëlqeu më së shumti nga ajo shfaqje?

Pastaj nxënësit me ndihmën e mësimdhënësit i numërojnë institucionet kulturore në kuadër të komunës (shtëpi të kulturës, kinema, teatër, objekte fetare).

Në qoftë se në vendbanimin ku jetoni jetojnë njerëz të etnitetit tjetër theksohen edhe institucionet, përkatësisht objektet fetare të asaj bashkësie etnike. Nxënësve iu jepet aktivitet i pavarur të shkruajnë në temën:

„Manifestimi kulturor i cili mbahet në qytetin tim” ose, gjithashtu, për një të një nga traditat në komunë në të cilën ata kanë marrë pjesë (mund edhe temë tjetër në përzgjedhje të mësimitdhënësit)

## **AKTIVITETET EVALUATIVE**

Pasi nxënësit të shkruajnë hartimet, ngjiten fotografi të objekteve kulturore, fotografi nga manifestimet kulturore në komunë dhe përpunohet libër i klasës me titull: „Jeta kulturore në qytetin tim”.

Libri prezantohet para gjithë klasës.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- nxënësi/nxënësja di se kultura është shumë e rëndësishme si pjesë përbërëse e jetës së njerëzve në bashkësinë lokale;
- mund të numërojë manifestime kulturore që janë mbajtur në komunë;
- emëron institucione kulturore në komunën e vet;
- di se duhet të respektohen kulturat e ndryshme;
- shpjegon si është zhvilluar manifestimi kulturor që i ka pëlqyer më së shumti.

## LITERATURA

1. Адамческа, С., (1996), „Активна настава“, Легис: Скопје
2. Арнаудова, В. Нацева, Б. Радевска, Ј. Дамчевска-Илиевска, В. (2000), „Приоди кон визуелно размислување“, БРО, Скопје
3. Vognar, L., Matijevic, M. (2002), „Didaktika“, Skolska knjiga, Zagreb
4. Дончовска, Д. (1988), „Методика по запознавање на природната и општествената средина“, Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ – Скопје
5. De Zan I. (2005), Metodika nastave prirode I drustva, Skolska knjiga, Zagreb
6. Закон за семејство, превземено од [www.pravo.org.mk](http://www.pravo.org.mk)
7. Закон за локалната самоуправа, превземено од [www.pravo.org.mk](http://www.pravo.org.mk)
8. Ивиќ, И., Пршикан А. Кијевчанин С. (1997г), „Активно учење – Приручник за примену активних метода наставе/учења“, Београд
9. Камчевска, Б. (2006), „Развој на програми и стратегии за автоинавтоиндивидуализација на децата“, Графо Б/С, Скопје
10. Lekić. D. (1991), „Metodika razredne nastave“, Nova prosveta, Beograd
11. М. В. Кларин (1995), „Педагошка технологија во наставниот процес“, Педагошки завод, Скопје
12. Ненси Клер, Ричард Холдгрив, Мишел Монсон, Џен Вестрик-, „Јазична писменост во почетните одделенија“ – Прирачник за обучувачи, Биро за развој на образованието – УНИЦЕФ (2011г)
13. Наставна програма по општество, за IV одделение, (2009), БРО, Скопје
14. Устав на Република Македонија
15. Филипина Негриевска...и др., под раководство на Виолета Петровска-Бешка (2009) „Прирачник за образование за животни вештини од IV до VI одделение-основно училиште“, Биро за развој а образованието,
16. м-р Горица Мицковска, Андријана Тасевска (2015), „Формативно оценување“, Биро за развој на образованието – УНИЦЕФ
17. Чекор по чекор (2007), „Унапредување на наставата по математика и запознавање на околината од I до III одделение“ – Материјали за обука
18. <http://www.kultura.gov.mk/>
19. [https://www.google.com/search?q=kartografski+znaci+na+republika+makedonija&tbm=isch&imgil=hy3EPj19T8AwrM%253A%253BSHTROjTph9ErdM%253Bhttps%25253A%25252F%25252Fwww.slideshare.net%25252Fzoranamarusic%25252Fznaci-geografski&source=iu&pf=m&fir=hy3EPj19T8AwrM%253A%252CSHTROjTph9ErdM%252C\\_&usg=\\_\\_L0gUHTi4dZCpNOdW8SglsDHFwNY%3D&biw=1440&bih=789&ved=0ahUKEwiWjYKE4L\\_WAhUFzxQKHal0CrUQyjclNQ&ei=rKfIWZaHIYWeU6LpqKgL#imgrc=hy3EPj19T8AwrM:](https://www.google.com/search?q=kartografski+znaci+na+republika+makedonija&tbm=isch&imgil=hy3EPj19T8AwrM%253A%253BSHTROjTph9ErdM%253Bhttps%25253A%25252F%25252Fwww.slideshare.net%25252Fzoranamarusic%25252Fznaci-geografski&source=iu&pf=m&fir=hy3EPj19T8AwrM%253A%252CSHTROjTph9ErdM%252C_&usg=__L0gUHTi4dZCpNOdW8SglsDHFwNY%3D&biw=1440&bih=789&ved=0ahUKEwiWjYKE4L_WAhUFzxQKHal0CrUQyjclNQ&ei=rKfIWZaHIYWeU6LpqKgL#imgrc=hy3EPj19T8AwrM:)
20. [www.geografija.pmf.ukim.edu.mk](http://www.geografija.pmf.ukim.edu.mk) Institut za biologija
21. YouTube, google.maps